

Nr: 03-121/2
Shkup: 22.06.2020

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 22.06.2020, solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e shqyrtoi Kërkesën për mendim të dorëzuar nga Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik me nr. 03-121/1 të datës 12.06.2020, dhe në lidhje me Rregulloren për instrumentin për mbështetje - Grante të Ko-financuara për zhvillimin teknologjik për tejkalimin e pasojave të Covid-19.

Për të përcaktuar nëse një masë e marrë nga dhënësi i ndihmës shtetërore paraqet ndihmë shtetërore, vlerësohet nëse katër kriteret e mëposhtme janë plotësuar në mënyrë kumulative:

- Një masë e tillë duhet të përfshijë transferim të mjeteve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të paraqet përfitim ekonomik për marrësin;
- Të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti

Komisioni vlerësoi se, duke pasur parasysh se Ko-financimi sipas Rregullores për instrumentin për mbështetje – Grantet e Ko-financuara për zhvillimin teknologjik për tejkalimin e pasojave të Covid-19, përfshin transferim të mjeteve shtetërore dhe paraqet një përfitim ekonomik për marrësin e ndihmës sipas nenin 3 të Rregullores për instrumentin për mbështetje – Grante të Ko-financuara për zhvillim teknologjik për tejkalimin e pasojave të Covid-19, e njëjta **paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.**

Sipas asaj që u tha më lartë, dhënësi i ndihmës shtetërore **ka për obligim** deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë Njoftim për dhënie të planifikuar të ndihmës në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të njoftimit për dhënie të ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 142/11), (në Formularin e dhënë si Shtojca I e Rregullores së mësipërme).

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски